



PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

KOMPANIA E SIGURIMEVE "ELSIG" SH.A.

31 DHJETOR 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	7
Shënime për pasqyrat financiare	8
SHTOJCA 1 Pasqyrat plotësuese	32

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët dhe menaxhmentin e Kompanisë së Sigurimeve Elsig Sh.a.

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Elsig Sh.a ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuldet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në Bazën për Opinion të Kualifikuar pjesë e raportit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare, dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportit Financiar (SNRF).

Baza për opinion të kualifikuar

- I. Siç është shpalosur në shënimin 11 të pasqyrave financiare, balanca e të arkëtueshmeve nga regreset të kompanisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 ishte në shumë prej 1,071 mijë euro, përkatësisht 708 mijë euro. Njohja e këtyre pasurive bazohet në paditë dhe pretendimet e iniciuara nga kompania kundrejt kompanive të tjera të sigurimeve dhe individëve për dëmet e paguara nga kompania dhe që konsiderohen të rikuperueshme nga kompanitë dhe individët e tjerë. Megjithatë, bazuar në informatat dhe provat e marra nga kompania, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse mbledhja e këtyre të arkëtueshmeve është pothuajse e sigurtë dhe nën kontrollin e kompanisë, kështu që ne nuk arritëm të marrim siguri në lidhje me vlefshmërinë dhe rikuperueshmërinë e këtyre pasurive më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018. Çdo rregullim që mund të jetë gjetur i nevojshëm në lidhje me më sipër, do të kishte një efekt të rëndësishëm në pozitën financiare të kompanisë më 31 dhjetor 2019, fitimi për vitin dhe shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare.
- II. Në përgatitjen e pasqyrave financiare shoqëruese, Kompania ka vlerësuar provizionet për dëmet e ndodhura por jo të raportuara ("IBNR") duke përdorur metodën e shkallëve zinxhir bazuar në dëmet e paguara. Metodologjia e shkallëve zinxhir e përdorur nga menaxhmenti për vlerësimin e IBNR nuk është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare aktuaristike, sepse rezultati i llogaritjes së rezervës të IBNR nuk është shpërndarë në mënyrë adekuate për vitet e aksidenteve. Duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare aktuaristike, vlerësuam se rezerva e IBNR më 31 dhjetor 2019 është nënvlerësuar. Për më tepër, në analizën e mjaftueshmëris të provizioneve për dëmet e raportuara por jo të rregulluara (Run Off) të RBNS rezultoi në rezerva të pamjaftueshme të RBNS. Poashtu, shënimet në pasqyrat financiare nuk japin informacion të mjaftueshëm për këto çështje, ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare dhe rreziqet e pasojave të tjera që mund të rezultojnë. Si rezultat i çështjeve të cekura më lart, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë me siguri të mjaftueshme ndryshimet e nevojshme në detyrimet bruto të dëmeve më 31 Dhjetor 2019, megjithatë sipas mendimit tonë; vlera e rregullimeve të mëtejshme është materiale.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin *'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'* në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabillistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

Informata të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat e tjera. Informatat tjera përfshijnë një shtojcë e cila përmban "Margjinën e Solvencës", "Logaritjen e Kapitalit" dhe "Mjaftueshmërinë e investimeve së aseteve në mbulim të provizioneve teknike"

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon të dhënat e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë të konkluzioneve të sigurimit. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat e tjera dhe, duke vepruar kështu, të shqyrtojmë nëse informatat e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të fituara në auditim, ose përndryshe duket se përmbajnë gabime materiale.

Nëse, bazuar në punën që kemi bërë në informacionet e tjera të fituara para datës së këtij raporti të auditorit, ne konkludojmë se ka një gabim material të këtij informacioni tjetër, ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç është përshkruar në bazën e opinionit të kualifikuar më lart, ne nuk ishim në gjendje të siguronim dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vlerën kontabël të aseteve tjera dhe detyrmet bruto të dëmeve më 31 dhjetor 2019. Prandaj nuk mund të konkludojmë nëse informatat tjera përmbajnë gabime materiale si rezultat i këtyre çeshtjeve.

Çështjet kryesore të auditimit

Me përjashtim të çështjeve të përshkruara në seksionin për *Bazën e Opinionit të Kualifikuar* ne kemi përcaktuar që nuk ka çështje të tjera kryesore të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe ata të ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të kryer veprimtarinë në vlijmësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështje që kanë të bëjnë me vijshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur menaxhmenti synon të ndërpres aktivitetin, ose nuk ka alternative tjetër reale përveç se më sipër.

Personat e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.

- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu u sigurojmë atyre që janë të ngarkuar për qeverisjen me një deklaratë se ne kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe komunikojmë me ta të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe prandaj janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullatore

Takimi i aksionarëve të Elsig Sh.a na ka caktuar në 30 korrik 2019 si auditorë të Kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019. Ky është viti i dytë radhazi si auditorë të Kompanisë.

Ne konfirmojmë se:

- Opinioni ynë i auditimit për pasqyrat financiare të shprehura këtu është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit të Kompanisë.
- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të përmendura në nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Kosovë
9 qershor 2020



Astrit Kelmendi

Partner i Angazhimit

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2019

	Shënimet	2019 EUR '000	2018 EUR '000
PASURITË			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	6	377	40
Depozitat me afat	7	9,071	7,766
Investimet në instrumentet financiare	8	2,828	2,788
Pjesa e risiguruesve të detyrimeve të sigurimit		768	690
Kostot e përvetësuara të shtyra	9	957	805
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet	10	1,252	1,448
Pasuri të tjera	11	2,144	2,027
Prona, pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurisë	12	604	218
Pasuritë e paprekshme	13	6	6
GJITHSEJ PASURITË		18,007	15,788
KAPITALI			
Kapitali aksionar	19	4,333	4,333
Fitimet e mbajtura		1,462	1,192
GJITHSEJ KAPITALI		5,795	5,525
DETYRIMET			
Detyrimet bruto të dëmeve	14	5,648	5,240
Provizioni për primet e pafituara	15	5,197	4,137
Detyrimet nga sigurimi	16	256	288
Detyrime të tjera	17	733	598
Detyrimet e Qirasë	18	378	-
GJITHSEJ DETYRIMET		12,212	10,263
GJITHSEJ KAPITAL DHE DETYRIMET		18,007	15,788

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 4 Qershor 2020 dhe janë nënshkruar nga:


Rexhep Idrizaj
Drejtor Ekzekutiv




Valdete Cikaqi
Drejtoreshë Financiare

PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAT TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2019

	Shënimet	2019 EUR '000	2018 EUR '000
Primet e shkruara bruto	20	10,074	7,902
Minus: Tatimi në prime	24	(297)	(395)
Minus: Primet e lëshurara për ri-siguruesit		(627)	(467)
PRIMET E SHKRUARA NETO		9,150	7,040
Ndryshimi neto në provizionin e primeve të pafituara		(1,060)	40
Pjesa e risiguruesve në ndryshimin neto të rezervave për primet e pafituara		77	(2)
PRIMET E FITUARA NETO		8,167	7,078
Komisioni nga risiguruesi		(64)	(36)
Të ardhurat nga interesi		285	303
Shpenzimet e interesit nga qiratë		(23)	
Të ardhura të tjera	21	567	1,067
GJITHSEJ TË ARDHURAT		8,932	8,412
Dëmet e ndodhura	14	(4,438)	(4,250)
Pjesa e shpenzimeve për BKS-ne	22	(223)	(193)
Nënshkrimi dhe kostot e blerjes së policave		152	29
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit		(272)	(83)
Shpenzimet administrative	23	(3,881)	(3,565)
GJITHSEJ SHPENZIMET		(8,662)	(8,062)
FITIMI PËR VITIN		270	350
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE		270	350

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2019

	Kapitali aksionar EUR '000	Fitimet e mbajtura EUR '000	Gjithsej EUR '000
MË 1 JANAR 2019	4,333	1,192	5,525
Transaksionet me pronarët	-	-	-
Pagesa e Dividendës	-	-	-
Gjithsej transaksione me pronarët	-	-	-
Fitimi për vitin	-	270	270
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE	-	270	270
MË 31 DHJETOR 2019	4,333	1,462	5,795
MË 1 JANAR 2018	4,333	1,542	5,875
Transaksionet me pronarët	-	-	-
Pagesa e Dividendës	-	(700)	(700)
Gjithsej transaksione me pronarët	-	(700)	(700)
Fitimi për vitin	-	350	350
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
GJITHSEJ TË ARDHURAT GJITHËPËRFSHIRËSE	-	350	350
MË 31 DHJETOR 2018	4,333	1,192	5,525

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2019

	Shënimet	2019 EUR'000	2018 EUR'000
AKTIVITETET OPERATIVE			
Fitimi për vitin		270	350
<i>Rregulluar për artikujt jo-monetar:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12&13	272	83
Të ardhura nga interesi		(285)	(303)
Shpenzimet e interesit		23	-
Zhvlerësimi i provizioneve		170	150
		450	280
<i>Ndryshimet ne asetet dhe detyrimet operative</i>			
Kostot e përvetësuar të shtyra		(152)	(29)
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet		101	45
Pjesa e risiguruesve të detyrimeve të sigurimit		(77)	6
Pasuritë e tjera		(194)	(832)
Detyrimet bruto të dëmeve		408	793
Provizion për primet e pafituara		1,060	(40)
Detyrimet nga sigurimi		(32)	(52)
Detyrimet tjera		135	3
Pagesa e interesit		(23)	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		1,676	174
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pasurive fikse		(104)	(12)
Rritja e depozitave me afat		(1,312)	(292)
Zvogëlimi i investimeve në instrumenteve financiare		-	276
Interesi i pranuar		252	323
Paraja neto e (përdorur) /gjeneruar në aktivitete investive		(1,164)	295
AKTIVITETET FINANCUESE			
Pagesa e Dividenës		-	(620)
Pagesat e Qirasë		(175)	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		(175)	(620)
NDRYSHIMI NETO NË PARA DHE EKVIVALENTËT E SAJ			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim		40	191
PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ NË FUND	6	377	40

1. TË PËRGJITHSHME

Kompania e Sigurimit Elsig Sh.A. ("Kompania") është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me regjistrimin Nr. 810791823 si shoqëri aksionere. Kompania është 100% e zotëruar nga z. Agim Elshani.

Kompania është e licencuar si një shoqëri sigurimi jo-jetë. Aktiviteti kryesor i biznesit i kompanisë është sigurimi motorik i përgjegjësisë së palës së tretë dhe klasa të tjera të sigurimit të tilla janë:

- Sigurimi i pronës;
- Sigurim shëndetsor
- Të gjitha risqet gjatë Ndërtimit (CAR);
- Sigurimi i shëndetit në udhëtim;
- Aksidentet personale;
- Kasko, etj.

Selia e regjistruar e Kompanisë gjendet në rrugën Tringe Smajli nr 19, Prishtinë, Republika e Kosovës.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kryesore kontabël të miratuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është përcaktuar ndryshe.

A. BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË ME SNRF

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazën e vijmësisë dhe në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), duke qenë Standarde dhe Interpretime të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), që janë në fuqi më 31 dhjetor 2019.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Euro (€) të rumbullaksuara në shumën më të përafërt (€ 000), përveç nëse e përcaktuar ndryshe.

Kompania paraqet pasqyrën e saj të pozicionit financiar në përgjithësi në renditje të likuiditetit. Një analizë në lidhje me rikuperimin ose shlyerjen brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit (jo më shumë se 12 muaj) dhe më shumë se 12 muaj pas datës së raportimit (më shumë se 12 muaj) është paraqitur në shënimin përkatës.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike kontabël. Gjithashtu kërkohet që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet e përafërta janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 3: Gjykim i rëndësishëm dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësimit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në mijëra euro, përveç nëse është përcaktuar ndryshe. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese janë ri-klasifikuar në përputhje me ndryshimet në prezantimin për vitin.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

Zbatimi i kërkesave të reja të SNRF-së

Kompania ka zbatuar standardet dhe ndryshimet e mëposhtme për herë të parë për vitin financiar që fillon më 1 Janar 2019.

SNRF 16 Qira

Standardi zëvendëson SNK 17 'Qira' dhe për qiramarrësit eliminon klasifikimin e qirave operative dhe qirave financiare. Me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët, aktivet e përdorimit të së drejtës dhe detyrimet përkatëse të qirasë njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Njohja e shpenzimeve të qirasë operative në linjë të drejtpërdrejtë zëvendësohet me një tarifë zhvlerësimi për aktivet e përdorimit të së drejtës (përfshirë në kostot operative) dhe një shpenzim interesi për detyrimet e njohura të qirasë (përfshirë në kostot e financës). Në periudhat e mëparshme të qirasë, shpenzimet që lidhen me qiranë sipas SNRF 16 do të jenë më të larta kur krahasohen me shpenzimet e qirasë nën SNK 17. Sidoqoftë, rezultatet e EBITDA (Fitimet Para Interesit, Taksave, Zhvlerësimit dhe Amortizimit) përmirësohen pasi shpenzimi operativ është tani zëvendësuar nga shpenzimet e interesit dhe zhvlerësimi në fitim ose humbje. Për klasifikimin brenda pasqyrës së fluksit të parave, pjesa e interesit shpaloet në aktivitetet operative dhe pjesa kryesore e pagesave të qirasë shpaloet veçmas në aktivitetet e financimit. Për kontabilitetin e qiradhënësit, standardi nuk ndryshon në mënyrë thelbësore se si një qiradhënës llogaritet me qira. Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, me efektin kumulativ të miratimit të SNRF 16 duke u njohur në kapitalin e tij si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të mbajtura për periudhën aktuale. Periudhat e mëparshme nuk janë riparuar. Shuma e njohur në lidhje me të drejtën e përdorimit të pasurive dhe detyrimin e qirasë, shpaloet në shënimin 12 Pronë, paisjet dhe e drejta e përdorimit dhe shënimin 18 detyrimet e qirasë.

Kërkesat e reja të nxjerra të SNRF ende jo efektive ose të adpotuara nga Kompania

Kompania nuk ka zbatuar standardet dhe interpretimet e reja ose të ndryshuara që janë nxjerrë nga BSNK, por që ende nuk janë në fuqi për vitin financiar që fillon më 1 Janar 2019.

Menaxhmenti parashikon që Standardet, Ndryshimet dhe Interpretimet e reja do të miratohen në pasqyrat financiare të Kompanisë kur ato të hyjnë në fuqi. Kompania ka vlerësuar, aty ku është e mundur, ndikimin potencial të të gjitha këtyre kërkesave të reja që pritet të hyjnë në fuqi në periudhat e ardhshme.

B. VALUTA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE

Artikujt e përfshirë në pasqyrat financiare maten duke përdorur valutën e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Kompania ("valuta funksionale"). Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, që është valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë.

C. PRONA DHE PAJISJET

Në njohjen fillestare, artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve njihen me koston, e cila përfshin çmimin e blerjes, si dhe çdo kosto që i atribuohet drejtpërdrejtë sjelljes së pasurive/aktivit në vendin dhe gjendjen e nevojshme për të qenë në gjendje të veprojnë në mënyrën e synuar nga Menaxhmenti. Pas njohjes fillestare, artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve barten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga dëmtimi. Zhvlerësimi llogaritet në mënyrë që të shlyejë koston e një pasurie/aktivi, minus vlerën e vlerësuar të mbetur, gjatë jetëgjatësisë së tij/saj si më poshtë:

Normat e zhvlerësimit

	Afat më i shkurtër i jetëgjatësisë së pasurive ose afatit të qirasë
Përmirësimet e objekteve me qira	10%
Kompjuterët dhe pajisjet e lidhura/të ngjashme	10%
Mobilet, orenditë dhe pajisjet e tjera	20%
Veturat	20%

Jetëgjatësia, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen dhe përshtaten sipas rrethanave, në fund të çdo periudhe raportuese, me ndikimin e çdo ndryshimi në vlerësimin e përafërt që trajtohet në një bazë prospektive. Një artikull i pronës dhe pajisjeve çregjistrohet kur nuk përdoret ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi i vazhdueshëm i pasurisë. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga shitja ose nxjerrja nga funksioni i një artikulli të pronës, impiantit dhe pajisjeve, është përcaktuar si diferencë midis të ardhurave të shitjes dhe vlerës kontabël të pasurisë dhe njihet në fitim ose humbje.

D. DREJTA E PËRDORIMIT TË PASURISË

E drejta e përdorimit të pasurisë njihet në datën e fillimit të qirasë. E drejta e përdorimit të pasurisë matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë, të rregulluar për, ashtu siç është e aplikueshme, për çdo pagesë të qirasë të bërë gjatë ose para datës së fillimit neto nga çdo lehtësim apo zbritje të pranuar, çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar përveç kur përfshihen në koston e inventarëve, një vlerësim i kostove që pritet të bëhen për çmontimin dhe heqjen e pasurisë themelore dhe kthimin e gjendjes së mëparshme të hapësirës punuese apo pasurisë.

E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohet në bazë të drejtpërdrejtë për periudhën e pashlyer të qirasë ose jetëgjatësisë së vlefshme të pasurisë, cilado që është më e shkurtër. Kur njësi ekonomike e konsoliduar pret që të marrë pronësinë mbi pasurinë e dhënë me qira në fund të afatit të qirasë, zhvlerësimi është mbi kohën e saj të dobishme. E drejta e përdorimit të pasurisë i nënshtrohen zhvlerësimit ose rregullohet për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë.

Kompania ka zgjedhur të mos njohë të drejtën e përdorimit të pasurisë dhe detyrimin korrespondues të qirasë për qiratë afatshkurtra me afat 12 muaj ose më pak dhe qiramarrje me vlerë të vogla. Pagesat e qirasë në këto asete trajtohen si shpenzime në fitim ose humbje ashtu siç ndodhin

E. PASURITË E PAPERKSHME

Pasuritë e paprekshme maten fillimisht me kosto. Pasuritë e paprekshme njihen nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që i atribuohen asaj pasurie do të rrjedhin në ndërmarrje dhe kostoja e pasurisë mund të matet në mënyrë të besueshme. Pas njohjes fillestare, pasuritë e paprekshme maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi/zhvlerësimi. Pasuritë e paprekshme amortizohen në bazë të linjës së drejtpërdrejtë mbi vlerësimin më të mirë të jetëgjatësisë së tyre, nëse ka. Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat e softuerëve dhe amortizohen në bazë lineare përgjatë 5 viteve.

F. ZHVLERËSIMI I PASURIVE JO-FINANCIARE

Zhvlerësimi/dëmtimi i pronave, impianteve dhe pajisjeve dhe i pasurive të paprekshme me jetëgjatësi të fundme

Vlera kontabël e pasurive të tilla shqyrtohet në çdo datë raportimi për indikacionet e zhvlerësimit dhe kur një pasuri është zhvlerësuar, ajo shënohet si një shpenzim përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes në shumën e tij/saj të llogaritur të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostot e shitjes/largimit së pasurisë individuale ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare. Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një pasuri individuale, përveç nëse pasuria nuk gjeneron rrjedhë të parasë së gatshme të cilat janë kryesisht të pavarura nga ato pasuri të tjera ose pasuri të Kompanisë. Nëse është kështu, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket pasuria.

Vlera në përdorim është vlera aktuale e rrjedhës së vlerësuar të ardhshme të parasë së gatshme të pasurive/njesisë. Vlerat aktuale janë llogaritur duke përdorur normat e zbritjes para tatimit që pasqyrojnë vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të pasurisë/njesisë, zhvlerësimi/dëmtimi i të cilit/cilës është duke u matur.

Rritjet e mëpasshme në shumën e rikuperueshme të shkaktuara nga ndryshimet në vlerësimet janë kredituar në fitim ose humbje në atë masë që ato e kthejnë prapa zhvlerësimin.

G. INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja fillestare dhe matja

Kompania njeht një pasuri financiare ose një detyrim financiar në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kur dhe vetëm kur bëhet palë në dispozitat kontraktuese të instrumentit. Në njohjen fillestare, Kompania njeht të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë. Vlera e drejtë e një pasurie/detyrimi financiar në njohjen fillestare zakonisht përfaqësohet nga çmimi i transaksionit. Çmimi i transaksionit për pasuritë/detyrimet financiare të ndryshme nga ato të klasifikuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes përfshijnë kostot e transaksionit të cilat i atribuohen drejtpërdrejt blerjes/emetimit të instrumentit financiar. Kostot e transaksionit të rrjedhura nga blerja e një pasurie financiare dhe emetimi i një detyrimi financiar të klasifikuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes paraqiten si shpenzime menjëherë. Kompania njeht pasuritë financiare duke përdorur kontabilitetin e datës së shlyerjes, kështu që një pasuri njihet në ditën kur është pranuar nga Kompania dhe është çregjistruar në ditën kur është dorëzuar nga Kompania.

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Matja e mëpasshme e pasurive financiare varet nga klasifikimi i tyre në njohjen fillestare. Kompania klasifikon pasuritë financiare në njërën nga dy kategoritë vijuese:

(a) Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv përveç atyre që Kompania synon të shesë në afat të shkurtër ose që i ka përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizioni për zhvlerësim. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve, paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre dhe pasuritë e tjera gjithashtu klasifikohen në këtë kategori.

(b) Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim

Pasuritë financiare të mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivative me maturim fiks ose të përcaktueshëm, përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e kredive dhe llogarive të arkëtueshmeve që menaxhmenti i Kompanisë ka qëllim dhe aftësi pozitive për ti mbajtur deri në maturim. Këto pasuri fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizioni për zhvlerësim. Një provizion për zhvlerësimin e letrave me vlerë të borxhit të mbajtura deri në maturim konstatohet atëherë kur ka dëshmi objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas afateve të tyre origjinale. Depozitat me afat dhe investimet në letra me vlerë klasifikohen në këto kategori.

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Në fund të çdo periudhe raportuese, Kompania vlerëson nëse pasuritë e saj financiare janë të zhvlerësuara, bazuar në dëshmi objektive që, si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare, rrjedhjet e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara të (Kompania) pasurive financiare janë ndikuar. Dëshmia objektive e zhvlerësimit mund të përfshijë vështirësi të konsiderueshme financiare të palës tjetër, shkelje të kontratës, probabiliteti që huamarrësi do të hyjë në falimentim, zhdukjen e një tregu aktiv për atë pasuri financiare për shkak të vështirësive financiare etj.

Përveç kësaj, për llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve që vlerësohen të mos zhvlerësohen në mënyrë individuale, Kompania i vlerëson ato kolektivisht për zhvlerësim, bazuar në përvojën e kaluar të Kompanisë për mbledhjen e pagesave, rritjen e pagesave të vonuara në portofol, ndryshimet e dukshme në kushtet ekonomike që lidhen me vonesë në llogaritë e arkëtueshme, etj. Vetëm për llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve, vlera kontabël zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të kompensimit dhe rikuperimet pasuese të shumave të shlyera më parë janë kredituar kundrejt llogarisë së kompensimit. Ndryshimet në vlerën kontabël të llogarisë shtesë njihen në fitim ose humbje. Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, vlera kontabël reduktohet drejtpërdrejt nga humbja nga zhvlerësimi. Për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar, nëse shumat e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet në

një periudhë të mëpasshme dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit, humbja e zhvlerësimit e njohur më parë është anuluar/kthyer prapa (drejtpërsëdrejti ose duke rregulluar llogarinë e kompensimit për llogaritë e arkëtueshme tregtare) nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, anulimi nuk duhet të rezultojë në një vlerë kontabël që tejkalon atë që kostoja e amortizuar e pasurisë financiare do të kishte qenë nëse zhvlerësimi nuk do të njihet në datën kur zhvlerësimi është i anuluar/kthyer prapa.

Mosnjohja

Pavarësisht nga forma juridike e transaksioneve, pasuritë financiare çregjistrohen kur ato kalojnë testin e mosnjohjes bazuar në "substancën mbi formën" të përshkruar nga SNK 39. Ky test përfshin dy lloje të ndryshme të vlerësimeve të cilat zbatohen në mënyrë rigoroze në rend:

- Vlerësimi i transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë
- Vlerësimi i transferimit të kontrollit.

Nëse pasuritë njihen / çregjistrohen plotësisht ose njihen në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Kompanisë, varet nga analiza e saktë e cila kryhet në bazë të një transaksioni të veçantë.

Matja pasuese e detyrimeve financiare

Matja e pasuese e detyrimeve financiare varet nga mënyra se si janë kategorizuar në njohjen fillestare. Kompania klasifikon detyrimet financiare në detyrime të tjera financiare.

Detyrimet e tjera financiare

Të gjitha detyrimet të cilat nuk janë klasifikuar në kategorinë e mëparshme bien në këtë kategori të mbetur. Këto detyrime mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Në mënyrë tipike, detyrimet nga sigurimi dhe detyrimet tjera klasifikohen në këtë kategori. Artikujt e klasifikuar në kuadër të llogarive të pagueshme tregtare dhe të tjera zakonisht nuk ri-maten, pasi obligimi është i njohur me një shkallë të lartë sigurie dhe shlyerja është afatshkurtër.

Mosnjohja e detyrimeve financiare

Një detyrim financiar largohet nga pasqyra e pozicionit financiar të Kompanisë vetëm kur detyrimi të jetë përmbushur, anuluar ose skaduar (d.m.th. shuar). Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të mos njohur dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

H. DETYRIMI I QIRASË

Detyrimi i qirasë njihet në datën e fillimit të qirasë. Detyrimi i qirasë fillimisht njihet në vlerën e tanishme të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë, që zbritet duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, atëherë zbatohet norma e konsoliduar rritëse e huazimit. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse minus çdo zbritje të pranuar në qira, pagesat variable të qirasë që varen nga ndonjë indeks apo normë interesi, shumat që pritet të paguhen për vlerën e mbetur të garantuar, çmimin për ushtrimin e opsionit të blerjes, kur një ushtrim i tillë është mjaft i sigurt se do të ndodhë, dhe çdo gjë që ndërlidhet me përfundimin e kontratës. Pagesat e ndryshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose një normë përfshihen në shpenzimin e periudhës në të cilën ato ndodhin.

Detyrimet e qirasë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Vlerat bartëse rivlerësohen nëse ka një ndryshim si në vijim: pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose një normë e përdorur; garanci e mbetur; afati i qirasë; sigurinë e një opsioni blerjeje dhe gjërat e përfundimit të kontratës. Kur një detyrim i qirasë është ri-vlerësuar, bëhet një rregullim në pasurinë korresponduese të së drejtës së përdorimit, ose në fitim apo humbje nëse vlera kontabël e të drejtës së pasurisë është zbritur tërësisht.

Qiradhëniet në të cilat një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra nën qiranë operative ngarkohen në fitim ose humbje në baza lineare gjatë periudhës së qirasë.

I. KLASIFIKIMI I PRODUKTEVE

Kontratat e sigurimit janë ato kontrata ku Kompania (siguruesi) ka pranuar rrezik të konsiderueshëm të sigurimit nga një palë tjetër (mbajtësit e policave) duke u pajtuar që të kompensojë mbajtësit e policave nëse një ngjarje e caktuar e pasigurt në të ardhmen (ngjarja e siguruar) ndikon negativisht në të siguruarit. Si një udhëzues i përgjithshëm, Kompania përcakton nëse ka rrezik të konsiderueshëm të sigurimit, duke krahasuar përfitimet e paguara me përfitimet e pagueshme nëse ngjarja e siguruar nuk ka ndodhur. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe riskun financiar.

Kontratat e investimit janë ato kontrata që transferojnë risk të madh financiar. Risku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë të një norme specifike të interesit, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallrave, kursit të këmbimit, indeksit të çmimeve ose normave, vlerësimit të kredisë ose indeksit të kredisë ose variabileve të tjera, me kusht që në rast të ndonjë variabli jo-financiar që variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe riskun financiar.

Kur një kontratë është klasifikuar si një kontratë sigurimi, mbetet një kontratë sigurimi për pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së saj, edhe nëse risku i sigurimit zvogëlohet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç nëse të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose mbarojnë.

J. DETYRIMET E KONTRATAVE TË SIGURIMEVE

Detyrimet e kontratave të sigurimeve të jo-jetës njihen atëherë kur lidhen kontratat dhe paguhen primet. Këto detyrime njihen si dispozita të dëmeve të papaguara, të cilat bazohen në koston përfundimtare të vlerësuar të të gjitha kërkesave të ndodhura por që nuk janë shlyer në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar, qoftë të raportuar apo jo. Detyrimi çregjistrohet kur kontrata skadon, shkarkohet ose anulohet.

Rezervat për primet e pa fituara përfshijnë primet e marra për risqet që ende nuk kanë skaduar. Në përgjithësi, rezervat lirohen gjatë afatit të kontratës dhe njihen si të ardhura të primeve.

Në çdo datë raportimi, kryhet një test i mjaftueshmërisë së detyrimeve. Ndryshimet në kërkesat e pritshme që kanë ndodhur, por të cilat nuk janë shlyer, pasqyrohen me rregullimin e provizionit për kërkesat e papaguara. Provizioni për riskun e pa skaduar rritet në masën që kërkesat e ardhshme në lidhje me kontratat aktuale të sigurimit tejkalojnë primet e ardhshme plus provizionet aktuale të primeve të pa fituara.

Kërkesat që rrjedhin nga biznesi i përgjithshëm i sigurimeve

Kërkesat e shkaktuara në lidhje me biznesin e përgjithshëm përbëhen nga kërkesat e paguara ndaj mbajtësve të policave gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimet në vlerësimin e detyrimeve për kërkesat e papaguara.

Detyrimet e dëmeve përbëhen nga provizionet e vlersuara nga Kompania për shpenzimet përfundimtare të shlyerjes së të gjitha kërkesave të kryera por të papaguara në datën e raportimit qoftë të raportuar ose jo, dhe shpenzimet e trajtimit të kërkesave të brendshme dhe të jashtme dhe marginën prudenciale. Përderisa Menaxhmenti konsideron se provizionet bruto për kërkesat dhe mbulimet e ri-sigurimeve përkatëse janë deklaruar në mënyrë të drejtë në bazë të informacionit që aktualisht është në dispozicionin e tyre, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në rregullim të rëndësishëm me shumat e siguruara. Rregullimi me shumat e provizioneve të kërkesave të vendosura në vitet e mëparshme pasqyrohen në pasqyrat financiare për periudhën në të cilën bëhen rregullimet.

Provizioni paraqet shpenzimet përfundimtare të vlerësuar të shlyerjes së të gjitha kërkesave duke përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta dhe indirekte të shlyerjes, që rrjedhin nga ngjarjet që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve përbëhen nga vlerësimet për humbjet e raportuara dhe provizionet për humbjet që nuk janë raportuar. Metoda e përdorur për të përcaktuar provizionet për kërkesat, bazohet në rregullat e aplikueshme në fuqi në vijim, por mbështetet gjithashtu nga vlerësimet aktuariale.

Provizioni për Dëmet e Raportuara por jo të Paguara (RBNS) vendoset rast pas rasti. Rezerva llogaritet si shuma e pritshme për të shlyer kërkesën dhe vlerësimet rregullohen pasi informacioni i ri bëhet i disponueshëm.

Më 31 dhjetor 2019 rezervat teknike për IBNR janë MPTL përcaktohen duke përdorur shkallën e zinxhirit, ndërsa për linjat e tjera të biznesit ato përcaktohen si përqindje e rezervave të RBNS. Përqindja vlerësohet nga aktuari i Kompanisë bazuar në të dhënat e jashtme dhe gjykimin aktuarial.

Ri-sigurimet

Kompania siguroi ri-sigurime në rrjedhën normale të biznesit me qëllim të kufizimit të humbjes së mundshme neto përmes diversifikimit të risqeve të saj që rrjedhin nga linjat e biznesit të MTPL, pronës, shëndetit, aksidenteve personale dhe linjave të tjera të biznesit.

Një ri-sigurim i tillë përfshin traktate dhe marrëveshje fakultative. Vetëm kontratat që krijojnë transferim të rëndësishëm të riskut të sigurimit dhe riskut të kohës, llogariten si sigurime. Marrëveshjet e ri-sigurimit nuk e lirojnë Kompaninë nga detyrimet e saj të drejtpërdrejta ndaj siguruesve të saj. Detyrimet e ri-sigurimit përbëhen nga detyrimet e pagueshme për kontratat e ri-sigurimit jashtë dhe njihen si një shpenzim i bazuar në shumën e përgjithshme të pajtuar me ri-siguruesin. Përfitimet e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrës e pozicionit financiar në baza bruto.

Rezervat e parashikuara të rikuperimit shpalosen veçmas si pasuri në pasqyrën e pozicionit financiar. Ri-sigurimet dhe rikuperimet tjera vlerësohen në një mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve të papaguara në përputhje me shumën e lidhura me kontratat e sigurimit themelor dhe në përputhje me kushtet e kontratës së ri-sigurimit.

Kostot e shtyra të blerjes

Shpenzimet e blerjes janë përcaktuar si shpenzime që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta, siç janë komisionet e agjentëve, tatami në prim dhe pagesat e provizionit të Bankës Qendrore të Kosovës.

Shpenzimet e shtyra të blerjes dhe shpenzimet e shtyra të origjinës amortizohen sistematikisht gjatë ekzistencës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Çdo shumë që nuk është e rikuperueshme shpenzohet. Ato çregjistrohen kur kontratat përkatëse zgjidhen ose shiten.

Testi i përshtatshmërisë së përgjegjësisë

Në çdo datë raportimi, Kompania kryen test për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të kërkesave. Testet primare të kryera janë analiza e normës së dëmeve dhe run off analiza.

Analiza e normës së dëmeve kryhet çdo vit për linjat kryesore të biznesit individualisht. Llogaritja kryhet vetëm për dëmet, si dhe kërkesat duke përfshirë kostot e blerjes dhe çdo shpenzim tjetër të trajtimit të kërkesave të jashtme. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Kompania merr në konsideratë vlerësimet aktuale të rrjedhjes dalëse të parave të gatshme. Kompania nuk zbret këto rrjedhje të parasë së gatshme të vlerësuar sepse shumica e kërkesave pritet të zgjidhen brenda një viti.

Përveç kësaj, kompania kryen çdo vit një run off analizë për rezervat e dëmeve, për të vlerësuar metodologjinë e rezervimit. Run off analiza kryhet në Dëmet e Raportuara por jo të Paguara (RBNS) dhe Dëmet e Ndodhura por jo të Raportuara IBNR veçmas, si dhe në baza të kombinuara. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha, përshtatjet e duhura bëhen në metodologjinë e rezervimit.

Nëse identifikohet ndonjë mangësi, do të faturohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provizion të papërcaktuar të riskut nga humbjet që rrjedhin nga Testi i Përshtatshmërisë së Përgjegjësisë.

Shpenzimet e trajtimit të kërkesave

Shpenzimet e trajtimit të kërkesave përbëhen nga shpenzimet e brendshme dhe të jashtme në lidhje me vlerësimin, trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga personeli i kompanisë si dhe shpenzimet e jashtme si tarifatat ligjore dhe shpenzimet e tjera. Menaxhmenti ka vlerësuar shpenzimet e trajtimit të kërkesave të barabartë me 3% (2018: 2.5%) të rezervës totale të RBNS (Dëmet e Raportuara por jo të Paguara), duke përjashtuar shpenzimet e trajtimit të Kërkesave të Kufirit dhe Fondet e Garancisë të cilat përcaktohen nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës.

K. NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat e Primeve

Primet e shkruara të biznesit të përgjithshëm përfshijnë primet për kontratat e ndodhura në vitin financiar, pavarësisht nëse ato lidhen tërësisht ose pjesërisht me një periudhë të mëvonshme kontabël. Primet e shkruara shpalosen bruto nga komisionet e pagueshme për ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet të bazuara në prime. Pjesa e fituar e primeve të pranuar njihet si e ardhur. Primet fitohen nga data e lidhjes së riskut, gjatë periudhës së zhdëmtimit, bazuar në modelin e risqeve të siguruara.

Provizioni për primet e pa-fituara përfshin proporcionin e primeve bruto të shkruara që vlerësohet të fitohen në vitin pasardhës financiar, duke përdorur bazën e përditshme proporcionale 1/365, përshtatur nëse është e nevojshme për të pasqyruar ndonjë ndryshim në rastet e riskut gjatë periudhës mbuluar nga kontrata. Megjithatë të gjitha produktet në fuqi nga Kompania kanë risk linear dhe nuk janë bërë rregullime për ndryshimin e risqeve.

Të ardhurat nga Interesi

Të ardhurat nga interesi grumbullohen në baza kohore, duke iu referuar kryegjësë së papaguar dhe normës efektive të interesit të aplikueshëm, që është norma që zbret saktësisht arkëtimet e ardhshme të parave nëpërmjet jetës së pritshme të pasurisë financiare ndaj vlerës kontabël neto të pasurisë.

L. NJOHJA E SHPENZIMEVE DHE KËRKESAVE PËRFITUESE

Dëmet e ndodhura

Dëmet e ndodhura përbëhen nga përfitimet dhe kërkesat e paguara ndaj të siguruarit, si dhe ndryshimet në vlerësimin bruto të sigurimit dhe të detyrimeve të kontratave të investimit, përveç ndryshimeve bruto në provizionet e primit të pa fituar të cilat regjistrohen në të ardhurat e primeve. Për më tepër përfshin kërkesat e brendshme dhe të jashtme të trajtimit të kërkesave që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin dhe shlyerjen e kërkesave. Kërkesat e sigurimeve regjistrohen në bazë të njoftimeve të pranuar.

M. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak.

N. DEPOZITAT ME AFAT

Depozitat me afat paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e kapitalit të papaguar dhe klasifikohen sipas maturimit të tyre. Depozitat me afat me maturim më pak se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të parasë, ato me afat maturimi mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet në baza akruale.

O. INVESTIMET NË INSTRUMENTET FINANCIARE

Investimet në instrumente financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit përfshihen si pjesë e matjes fillestare, përveç aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Pasuritë e tilla më pas maten me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë varësisht nga klasifikimi i tyre.

P. EKUITETI

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve që janë lëshuar. Aksionet klasifikohen si kapital neto kur nuk ka asnjë detyrim për të transferuar paratë ose pasuri të tjera.

Q. TATIMIMI

Tatimet e primit të caktuar janë kalkuluar në pajtueshmëri me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Kompanitë e sigurimeve paguajnë tatim prej 5% mbi primet bruto. Primet janë kthyer dhe rregullimet retrospektive të premiumit janë deduktuar nga primet bruto për të arritur tek baza e tatimit. Tatimi mbi primet e shkruara bruto paraqitet ndaras si zbritje nga primet e shkruara bruto

Tatimi në primit përbën një pjesë të kostove të blerjes dhe shtyhet në një mënyrë të përputhshme me metodën e llogaritjes së provizioneve të primeve të pafituara. Kompanitë e sigurimeve nuk kanë përgjegjësi të paguajnë tatimin mbi të ardhurat e korporatave për fitimin në Kosovë. Detyrimi për tatim në primit pushoi të jetë efektive nga 5 gusht 2019.

Tatimi mbi të ardhurat e korporatave

Efektive nga 5 Gusht 2019 në përputhje me Ligjin Nr. 06 / L-105 "Për tatimin mbi të ardhurat e korporatave", nga kompanitë e sigurimeve kërkohet të paguajnë tatimin mbi të ardhurat e korporatave në masën 10% në fitimet e tyre të tatueshme. Shkalla e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është fikse në 10%.

Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për periudhën që fillon nga data e hyrjes në fuqi e legjislacionit deri më 31 dhjetor 2019. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi kontabël ose sepse disa të ardhura dhe shpenzime nuk janë kurrë të tatueshme ose të zbritshme, ose sepse modeli kohor se ata janë të tatueshëm ose të zbritshëm ndryshon midis ligjit të tatimeve dhe trajtimit të tyre të kontabilitetit.

Shpenzimi tatimor për periudhën përfshin tatimin aktuale dhe të shtyrë nëse ka. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç nëse lind nga transaksione ose ngjarje që njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapitalin e vet. Në këtë rast, tatimi njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht. Kur tatimi lind nga llogaritja fillestare për një kombinim biznesi, ai përfshihet në kontabilitetin për kombinimin e biznesit. Tatimet tjera përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet në ndryshimet midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat e veçanta financiare dhe bazës përkatëse tatimore të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe llogariten për përdorimin e metodës së detyrimit të bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen përgjithësisht për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundur që fitimet e tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme.

Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe zvogëlohet në atë masë sa nuk është më e mundur që fitimet e mjaftueshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të lejuar që të gjithë ose një pjesë e aktivitetit të rikuperohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet në normat e taksave që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet ose aktivi i realizuar. Taksa e shtyrë ngarkohet ose kreditohet në fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me artikujt e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në kapitalin neto, në këtë rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në kapitalin neto.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë juridikisht e detyrueshme për të kompensuar aktivet tatimore aktuale ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me taksat e të ardhurave të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe Kompania synon të shlyejë aktivet dhe detyrimet e tanishme tatimore në baza neto.

Të ardhurat nga interesi të pranuar nga Kompania gjithashtu i nënshtrohen tatimit në burim në normë prej 10% (2018: 10%).

R. PËRFITIMET E PUNONJËSVE

Shpenzimet e përfitimeve të pensionit

Kompania nuk bën asnjë provizion dhe nuk ka asnjë detyrim për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në planin e pensioneve shtetërore, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

S. PROVIZIONET

Provizioni njihet kur Kompania ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e detyrim. Provizionet rishikohen në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe rregullohen në mënyrë që të pasqyrojnë vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është materiale, shumën e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

T. QIRATË

Qiratë afatëshkurta dhe qirat për pasuritë me vlerë të vogël njihen si shpenzim në pasqyrën e fitimit dhe humbjes. Qiratë afatëshkurtra janë qiratë me afat 12 muaj ose më pak.

U. NJOHJA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet operative njihen si fitim ose humbje pas njohjes së shërbimit ose në momentin kur ato ndodhin.

Pagesat e shpenzimeve operative

Pagesat për shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

Shpenzimet financiare

Interesi i paguar njihet në fitim ose humbje pasi që akumulon dhe llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Interesi i përllogaritur përfshihet brenda vlerës kontabël të detyrimit financiar me interes.

V. ZOTIMET DHE KONTIGJENTËT

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Pasuria e papritur nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset atëherë kur fluksi i përfitimeve ekonomike është i mundshëm.

Shuma e humbjes së papritur njihet si provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se një detyrim i shkaktuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që rezulton, mund të bëhet.

W. TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHURA

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Kompanisë, së bashku me subjektet të cilat ata i kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm mbi operacionet dhe menaxhimin e Kompanisë. Duke marrë parasysh çdo marrëdhënie të mundshme të palëve, vëmendja i drejtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

X. NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Ngjarjet pas periudhës raportuese që ofrojnë informacione shtesë për pozicionin e Kompanisë në pasqyrën e datës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) pasqyrohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës raportuese që nuk janë ngjarje të rregullimit shpalosen në shënimet kur janë materiale.

3. GJYKIME TË RËNDËSISHME DHE BURIMET KYÇE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT

Kompania bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme dhe relevante nën rrethanat. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit jo-jetë, vlerësimet duhet të bëhen si për koston përfundimtare të pritshme të kërkesave të raportuara në datën e pozicionit financiar dhe për koston përfundimtare të pritshme të humbjeve të shkaktuara por ende të pa raportuara në pasqyrën e datës së pozicionit financiar (IBNR). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara vlerësohet duke përdorur një varg teknikash projektimi të kërkesave standarde aktuariale.

Supozimi kryesor që qëndron në themel të këtyre teknikave është se eksperiencia e kaluar e zhvillimit të kërkesave të një kompanie mund të përdoret për të projektuar zhvillimin e kërkesave të ardhshme dhe kështu edhe koston përfundimtare të dëmeve. Si të tilla, këto metoda nxjerrin në pah zhvillimin e humbjeve të paguara dhe të shkaktuara, shpenzimet mesatare për një kërkesë dhe numrat e kërkesave bazuar në zhvillimet e vërejtura të viteve të mëparshme dhe raporteve të pritshme të humbjeve. Zhvillimi i kërkesave historike kryesisht analizohet me vite aksidenti, por gjithashtu mund të analizohet më tej sipas zonës gjeografike, si dhe nga linjat e rëndësishme të biznesit dhe llojet e kërkesave. Vlerësimi kualitativ shtesë përdoret për të vlerësuar shkallën në të cilën tendencat e kaluara nuk mund të zbatohen në të ardhmen, në mënyrë që të arrihet në koston përfundimtare të vlerësuar të kërkesave që paraqesin rezultatin e mundshëm nga gama e rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasiguritë e përfshira.

Humbjet e zhvlerësimit në llogaritë e arkëtueshme të primeve

Kompania shqyrton llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve dhe jo-sigurimeve për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën në bazë një vjetore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Kompania bën gjykimet nëse ka të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një ulje të matshme në rrjedhjen e ardhshme të parave të gatshme të vlerësuara nga një debitor individual. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së debitorit.

4. RISKU I SIGURIMIT DHE RISKU FINANCIAR

A. Korniza e qeverisjes

Objektivi kryesor i riskut dhe të menaxhimit financiar të kompanisë është mbrojtja e aksionareve të kompanisë nga ngjarjet që pengojnë arritjen e qëndrueshme të objektivave të performancës financiare, duke përfshirë dështimin në shfrytëzimin e mundësive. Menaxhmenti kryesor njih rëndësinë kritike për të pasur sisteme efikase dhe efektive të menaxhimit të riskut.

Bordi i drejtorëve miraton politikat e menaxhimit të riskut të Kompanisë dhe takohet rregullisht për të miratuar çdo kërkesë tregtare, rregullatore dhe organizative të këtyre politikave. Këto politika përcaktojnë identifikimin e riskut të kompanisë dhe interpretimin e saj, strukturën kufitare për të siguruar cilësinë dhe diversifikimin e duhur të pasurive, harmonizojnë strategjinë e nënshkrimit dhe ri-sigurimit me qëllimet e korporatave dhe specifikojnë kërkesat e raportimit.

B. Korniza rregulluese

Operacionet e Kompanisë gjithashtu i nënshtrohen kërkesave rregulluese brenda juridiksioneve ku operon. Këto rregullore jo vetëm që përshkruajnë miratimin dhe monitorimin e aktiviteteve, por gjithashtu imponojnë dispozita të caktuara kufizuese (p.sh. përshtatshmërinë e kapitalit, kërkesat e marginalitetit të aftësisë paguese) për të minimizuar riskun e mospagimit dhe paaftësisë paguese nga ana e shoqërive të sigurimit për të përmbushur detyrimet e paparashikuara kur ato paraqiten.

C. Strategjia e ri-sigurimit

Pjesa më e madhe e biznesit të sigurimit të dhënë është vendosur në një bazë humbjeje të tepërt (excess of loss), ndërsa për shëndetin në udhëtim linjën e biznesit kompania transferon e gjithë riskun të resiguruar. Shumat e rikuperueshme nga ri-siguruesit vlerësohen në një mënyrë që përputhet me kërkesat e dëmeve të papaguara dhe janë në përputhje me kontratat e ri-sigurimit. Megjithatë Kompania ka marrëveshje për ri-sigurim, nuk lirohet nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj të siguarve të saj dhe kështu ekziston një ekspozim kredie në lidhje me sigurimet e dhëna, deri në masën që ndonjë ri-sigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e marra sipas marrëveshjeve të ri-sigurimit. Vendosja e kompanisë e ri-sigurimit është e larmishme në atë mënyrë që nuk varet nga një ri-sigurues i vetëm.

D. Risku i sigurimit

Risku kryesor me të cilin përballë Kompania në bazë të kontratave të sigurimit është se kërkesat aktuale dhe pagesat e përfitimeve ose koha e tyre ndryshojnë nga pritjet. Kjo ndikohet nga shpeshësia e kërkesave, ashpërsia e kërkesave, përfitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi i mëvonshëm i kërkesave afatgjata. Prandaj, qëllimi i kompanisë është që të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion për të mbuluar këto detyrime.

Ekspozimi ndaj riskut zbutet nga diversifikimi në një portofol të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Ndryshueshmëria e risqeve është përmirësuar gjithashtu me përzgjedhjen e kujdeseshme dhe zbatimin e udhëzimeve të strategjisë së sigurimit, si dhe me përdorimin e marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Kompania blen ri-sigurime si pjesë e programit të lehtësimit të risqeve të saj. Ri-sigurimi i dhënë është vendosur në bazë proporcionale dhe jo-proporcionale. Pjesa më e madhe e ri-sigurimit proporcional është tejkalmi i ri-sigurimit të humbjes që merret për të kufizuar ekspozimin e përgjithshëm të Kompanisë në disa kategori të biznesit. Ri-sigurimi jo-proporcional është kryesisht ri-sigurimi i humbjes së tepërt i projektuar për të zbutur ekspozimin neto të kompanisë ndaj humbjeve nga katastrofa. Kufijtë e mbajtjes për ri-sigurimin e humbjes së tepërt ndryshojnë sipas linjës dhe territorit të produktit.

Shumat e rikuperueshme nga ri-siguruesit vlerësohen në një mënyrë që përputhet me kërkesat e provizioneve të papaguara dhe janë në përputhje me kontratat e ri-sigurimit. Megjithatë Kompania ka marrëveshje për ri-sigurim, nuk lirohet nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj të siguarve të saj dhe kështu ekziston një ekspozim kredie në lidhje me sigurimet e dhëna, deri në masën që ndonjë ri-sigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e marra sipas marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Kompania kryesisht lëshon këto lloje të kontratave të sigurimit: sigurimi i përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, sigurimi shëndetësor, sigurimi i pronës, sigurimi profesional të dëmshpërblimit dhe kontratave të tjera të sigurimit.

Për sigurimin e përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë, risku më i rëndësishëm është dëmi material dhe jo material që shkaktohet nga aksidentet. Për sigurimin e pronës dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor risqet më të rëndësishme janë: katastrofa natyrore, zjarri, aktivitetet terroriste, epidemitë, shkencat mjekësore dhe përmirësimet në teknologji.

Qëllimi i këtyre strategjive të sigurimit dhe ri-sigurimit është të kufizojë ekspozimin ndaj katastrofave bazuar në oreksin e riskut të kompanisë siç vendoset nga menaxhmenti. Mbjajtjet maksimale të sigurimit janë 10% e kapitalit.

31 Dhjetor 2019	Detyrimet Bruto	Pjesa e risiguruesit	Detyrimet Neto
Auto përgjegjësia	3,738	-	3,738
Sigurimi kufitar	811	-	811
Fondi i Kompensimit	958	-	958
Sigurimi Motor Casco	101	-	101
Produktet e tjera	38	-	38
GJITHSEJ	5,647	-	5,647

31 Dhjetor 2018	Detyrimet Bruto	Pjesa e risiguruesit	Detyrimet Neto
Auto përgjegjësia	3,357	-	3,357
Sigurimi kufitar	771	-	771
Fondi i Kompensimit	1,005	-	1,005
Sigurimi Motor Casco	101	-	101
Produktet e tjera	6	-	6
GJITHSEJ	5,240	-	5,240

E. Risku kreditor

Kompania nuk ka ndonjë përqendrim të konsiderueshëm të riskut kreditor. Kompania ka politika që kufizojnë shumën e ekspozimit kreditor për çdo palë të vetme të kundërt. Ekspozimi maksimal i Kompanisë ndaj riskut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në Pasqyrën e pozicionit financiar.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	377	40
Depozitat me afat	9,071	7,766
Investimet në instrumentet financiare	2,828	2,788
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,252	1,448
Pasuritë e tjera	2,144	2,027
EKSPOZIMET MAKSIMALE NDAJ RISKUT KREDITOR	15,672	14,069

Depozitat me Afat dhe Paraja e Gatshme dhe Ekuivalentët e saj. Të gjitha depozitat me afat dhe paratë e gatshme të mbajtura në llogarinë rrjedhëse janë në bankat e licencuara të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, ekspozimi ndaj një banke të vetme nuk duhet të kalojë 30% të depozitave me afat sipas politikave të Kompanisë dhe rregulloreve të BQK-së.

Llogaritë e arkëtueshme të Sigurimeve. Kompania menaxhon në mënyrë aktive përzierjen e produkteve të saj për të siguruar që nuk ka ndonjë përqendrim domethënës të riskut kreditor.

Investimet në instrumentet financiare. Këto investime përbëhen prej letrave me vlerë të lëshuara nga Republika e Kosovës.

Struktura e moshës së llogarive të arkëtueshme të sigurimeve deri më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

KOMPANIA E SIGURIMIT ELSIG SH.A.
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Deri në 30 ditë	299	218
Prej 1 deri në 2 muaj	237	166
Prej 3 deri në 6 muaj	455	570
Prej 6 deri në 12 muaj	261	492
Mbi 1 vit	703	610
Minus: provizioni i zhvlerësimit	(703)	(608)
LLOGARITË E ARKËTUESHME TË SIGURIMEVE, NETO	1,252	1,448

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
As të vonuara e as të zhvlerësuara	299	218
Të vonuara por jo të zhvlerësuara	953	1,230
Të zhvlerësuara	703	608
Minus: provizioni i zhvlerësimit	(703)	(608)
LLOGARITË E ARKËTUESHME TË SIGURIMEVE, NETO	1,252	1,448

Lëvizjet në provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme të primeve që janë vlerësuar për zhvlerësim kolektivisht janë si vijon:

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Që nga 1 Janari	608	518
Provizioni për zhvlerësim i njohur gjatë vitit	95	90
Më 31 dhjetor	703	608

F. Risku Tregut

Kompania merr përsipër ekspozimin ndaj risqeve tregtare. Risqet tregtare lindin nga pozicionet e hapura në (a) valutat e huaja dhe (b) pasuritë dhe detyrimet që mbajnë interes. Menaxhmenti përcakton kufijtë mbi vlerën e riskut që mund të pranohet, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve të konsiderueshme të tregut.

Risku i Normës së Interesit

Ekspozimi i kompanisë ndaj riskut të interesit lidhet me depozitat e vendosura në bankat lokale tregtare. Depozitat janë të deponuara në bankat me reputacion. Kërkesat e papaguara dhe provizionet për primet e pa-fituara nuk janë drejtpërdrejtë të ndjeshme ndaj normave të interesit të tregut, sepse ato nuk janë të zbritura dhe nuk mbartin interes.

Ekspozimi i aktiveve dhe detyrimeve të kompanisë në ndryshimet e normës së interesit dhe datat e rivlerësimit të kontratës në fund të periudhës raportuese janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2019	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Që nuk mbartin interes	Gjithsej
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	377	377
Depozitat me afat	350	180	8,541	-	9,071
Investimet në instrumentet financiare	-	2,828	-	-	2,828
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	-	-	-	1,252	1,252
Pasuritë e tjera	-	-	-	2,144	2,144
Gjithsej	350	3,008	8,541	3,772	15,672
Detyrimet bruto të dëmeve	-	-	-	5,648	5,648
Detyrimet nga sigurimi	-	-	-	256	256
Detyrimet e Qirasë	92	93	193	-	378
Detyrimet tjera	-	-	-	733	733
Gjithsej	92	93	193	6,637	7,015

31 Dhjetor 2018	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Që nuk mbartin interes	Gjithsej
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	-	-	-	40	40
Depozitat me afat	28	480	7,258	-	7,766
Investimet në instrumentet financiare	-	-	2,743	-	2,743
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	-	-	-	1,448	1,448
Pasuritë e tjera	-	-	-	2,027	2,027
Gjithsej	28	480	10,001	3,515	14,024
Detyrimet bruto të dëmeve	-	-	-	5,240	5,240
Detyrimet nga sigurimi	-	-	-	288	288
Detyrimet tjera	-	-	-	598	598
Gjithsej	-	-	-	6,126	6,126

Risku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit sepse të gjitha transaksionet e saj kryhen në valutën vendase.

G. Risku i Likuiditetit

Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parave të gatshme dhe ekuivalentëve të saj, pra, disponueshmëria e fondeve nëpërmjet linjave adekuate kreditore dhe aftësisë për të arkëtuar në kohën e duhur, brenda afateve të përcaktuara shumat e papaguara nga depozitat.

Ekspozimi i aktiveve dhe detyrimeve të kompanisë në ndryshimet e normës së interesit dhe datat e rivlerësimit të kontratës në fund të periudhës raportuese janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2019	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Gjithsej
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	377	-	-	377
Depozitat me afat	371	180	8,520	9,071
Investimet në instrumentet financiare	-	2,828	-	2,828
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,252	-	-	1,252
Pasuritë e tjera	2,144	-	-	2,144
Gjithsej	4,144	3,008	8,520	15,672
Detyrimet bruto të dëmeve	5,648	-	-	5,648
Detyrimet nga sigurimi	256	-	-	256
Detyrimet e Qirasë	93	92	193	378
Detyrimet tjera	733	-	-	733
Gjithsej	6,730	92	193	7,015

31 Dhjetor 2018	Deri në 6 muaj	6 muaj deri në 1 vit	Mbi 1 vit	Gjithsej
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	40	-	-	40
Depozitat me afat	28	480	7,258	7,766
Investimet në instrumentet financiare	-	-	2,743	2,743
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,448	-	-	1,448
Pasuritë e tjera	2,027	-	-	2,027
Gjithsej	3,543	480	10,001	14,024
Detyrimet bruto të dëmeve	5,240	-	-	5,240
Detyrimet nga sigurimi	288	-	-	288
Detyrimet tjera	598	-	-	598
Gjithsej	6,126	-	-	6,126

H. Menaxhimi i riskut të kapitalit

Objektivat e Kompanisë gjatë menaxhimit të kapitalit janë që:

- të mbrojnë aftësinë e saj për të vazhduar si një biznes i suksesshëm, në mënyrë që ajo të mund të vazhdojnë të ofroj kthim të investimeve për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera të interesit dhe
- të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit.

Kompania i nënshtrohet kërkesave minimale të kapitalit. Kërkesat e kapitalit monitorohen nga BQK-ja. Më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 Kompania ka qenë në Pajtueshmëri me kërkesat e kapitalit.

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Kapitali në dispozicion sipas Rregullores së BQK-së	4,248	3,253
Kapitali minimal i kërkuar	3,200	3,200
Teprica	1,048	53

5. VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të pranohet nga shitja e një pasurie ose që do të paguhet për transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlerat e drejta janë bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas profilit të bazës së pasurisë dhe detyrimit.

A. Instrumentet e sigurimit dhe financiare të matura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të matura sipas vlerës së drejtë në Pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i përcakton pasuritë dhe detyrimet financiare të Kompanisë në tre nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të pasurive financiare:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për pasuritë ose detyrimet identike;
- **Niveli 2:** të dhënat e tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për vëzhgimin e pasurive ose detyrimeve, drejtpërdrejt (p.sh. si çmimet) ose indirekt (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi pasuritë ose detyrimet që nuk janë të bazuara në të dhënat e disponueshme për vëzhgimin e tregut.

Nga datat e raportimit, Kompania nuk ka instrumente financiare të matura me vlerën e drejtë

Pasuritë financiare të pa-matura në vlerën e drejtë

Diferenca midis vlerës bartëse dhe vlerës së drejtë të atyre pasurive dhe detyrimeve financiare të cilat nuk janë paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Vlera bartëse	Vlera e drejtë	Vlera bartëse	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	377	377	40	40
Depozitat me afat	9,071	9,071	7,766	7,766
Investimet në instrumentet financiare	2,828	2,828	2,788	2,788
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,252	1,252	1,448	1,448
Pasuritë e tjera	2,144	2,144	2,027	2,027
Gjithsej	15,672	15,672	14,069	14,069
Detyrimet bruto të dëmeve	5,648	5,648	5,240	5,240
Detyrime nga sigurimi	256	256	288	288
Detyrimet e Qirasë	378	378	-	-
Detyrimet tjera	733	733	598	598
Gjithsej	7,015	7,015	6,126	6,126

Menaxhmenti ka vlerësuar se paratë e gatshme dhe depozitat me afat, llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve, llogaritë e tjera të pagueshme dhe provizionet e kërkesave përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumenteve.

6 PARAJA E GATSHME DHE EKVIVALENTËT E SAJ

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Paraja në dorë	10	10
Paraja në Bankë	367	30
GJITHSEJ PARAJA E GATSHME DHE EKVIVALENTËT E SAJ	377	40

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfaqësojnë paratë e gatshme të mbajtura në llogaritë rrjedhëse bankare.

7 DEPOZITAT ME AFAT

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Depozitat me afat në bankat komerciale lokale	8,730	7,417
Banka Qendrore e Kosovës	320	321
Interesi i përlogaritur	21	28
GJITHSEJ DEPOZITA ME AFAT	9,071	7,766

Maturimi i depozitave		2018 EUR'000
Maturimi Brenda një viti	530	480
Maturimi pas një viti	8,520	7,258
Interesi i përlogaritur	21	28
GJITHSEJ DEPOZITA ME AFAT	9,071	7,766

Depozitat me afat mbartin normën e interesit në shkallë prej 0.5 % deri 3.5 % në vit. (2018: 0.2 % deri 3.5 %). Shuma e të ardhurave nga interesi njohur për vitin 2019 është 179 mijë euro (2018: 194 mijë euro).

8 INVESTIMET NË INSTRUMENTET FINANCIARE

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Lëshuar nga Qeveria e Kosovës	2,783	2,743
Interesi i përlogaritur	45	45
GJITHSEJ INVESTIMET NË INSTRUMENTET FINANCIARE	2,828	2,788

Investimet në instrumentet financiare përbëhen nga obligacione qeveritare të lëshuara nga Republika e Kosovës. Bondet qeveritare kanë një normë mesatare të kthimit prej 3.83 % dhe e kanë një maturitetet deri më 31 Gusht 2020.

9 KOSTOT E PËRVETËSUARA TË SHTYRA

Kompania klasifikon shpenzimet e mëposhtme si shpenzime të shtyra të blerjes:

	31 December 2019 EUR'000	31 December 2018 EUR'000
Rrogat e agjentëve dhe shpenzimet e lidhura	736	548
Tatimi mbi primet 5%	150	207
Provizioni ndaj BQK-së	71	50
GJITHËSEJ SHPENZIMET E SHTYRA TË BLERJES	957	805

10 LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SIGURIMET

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve	1,898	1,951
Premia e arkëtueshme nga Byroja Kosovare e Sigurimit	57	105
Provizioni i zhvlersimit	(703)	(608)
LLOGARITË E ARKËTUESHME TË SIGURIMEVE	1,252	1,448

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimeve janë shuma e detyruar nga konsumatorët për primin e sigurimit për kontratat e sigurimit të shitura gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit. Mbledhja e shumës pritet të bëhet brenda një viti ose më pak. Për vjetërsimin dhe lëvizjen e llogarive të arkëtueshme të sigurimeve në provizionin për zhvlerësim, referojuni shënimit 4 E.

11 PASURITË E TJERA

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Të arkëtueshmet nga Administrata Tatimore	210	354
Regreset e arkëtueshme nga individual dhe kompanitë	1,071	708
Avanset për punëtorë dhe menaxhmentin	259	199
Parapagimet për furnitorët	479	641
Avanset e paguara bazuar në MM	125	125
GJITHSEJ PASURI TË TJERA	2,144	2,027

Gjatë vitit që përfundon me 31 dhjetor 2018, Kompania ka njohur të arkëtueshmet nga Administrata Tatimore dhe të hyra tjera në vlerë 354 mijë euro, të cilat kanë të bëjnë me tatimin shtesë të paguar gjatë vitit 2017. Njohja e pasurisë dhe e të ardhurave është bërë pasi që Kompania ka marrë vendimin e favorshëm të gjykatës lidhur me pagesat shtesë të taksave të vitit të kaluar nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Gjykata Themelore e Prishtinës ka miratuar pjesërisht kërkesën për padi të Kompanisë, megjithatë vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje do të marrë Gjykata e Apelit. Gjatë vitit 2019, Gjykata e Apelit ka vendosur në favor të Kompanisë dhe gjatë vitit shumë prej 225 mijë euro janë kompenzuar me detyrimet tatimore të Kompanisë. Po ashtu gjatë vitit 2019 janë njohur të hyra në shumë prej 81 mijë euro lidhur me rregullimet tatimore.

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2019, Kompania ka njohur të ardhura nga regresi në shumë prej 486 mijë euro (31 dhjetor 2018: 713 mijë euro). Njohja e të ardhurave dhe e të arkëtueshmeve bëhet në përputhje me legjislacionin lokal mbi përgjegjësinë e palës së tretë motorike dhe ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve. Të arkëtueshmet nga kompanitë e tjera të sigurimeve dhe individëve janë të lidhura me kërkesat e paguara nga Kompania. Megjithatë, meqenëse palët që shkaktuan aksidentet ishin të siguruar me sigurimin e automjeteve me përgjegjësi të palës së tretë në kompani të tjera të sigurimeve, kompania pret të kompensohet për këto shuma.

Avanset e paguara në bazë të memorandumit të mirëkuptimit përfaqësojnë paratë e depozituara (në formën e garancisë) nga secila kompani sigurimi në Raiffeisen Bank në Kosovë. Shuma prej 1,500 mijë eurosh u nda midis 12 kompanive të sigurimeve, 125 mijë euro secili prej tyre. Shuma e parash së gatshme e depozituar është rezultat i "Memorandumit të Mirëkuptimit" ndërmjet Shoqatës së Siguruesve Serb dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit si subjekte të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit të automjeteve në juridiksionin e secilës Palë me

lehtësimin e Këshillit të Byrosë dhe Njohja e Sigurimit të Përgjegjësive Motorike të Palëve të Treta (MTPL) dhe aranzhimet për përpunimin dhe pagesën e kërkesave.

12 PRONA DHE PAJISJET

	Përmirësimi i Qirasë	Kompjuterë dhe pajisje tjera	Mobilje dhe pajisje tjera	Vetura	E Drejta e përdorimit të pasurive (Ndërtesat)	Gjithsej
	EUR'000	EUR'000	EUR'000	EUR'000	EUR'000	EUR'000
Kosto						
Më 1 Janar 2018	104	222	190	420	-	936
Shtesat gjatë vitit	-	7	1	4	-	12
Më 31 Dhjetor 2018	104	229	191	424	-	948
Shtesat gjatë vitit	-	3	-	101	-	104
Kapitalizimi i qirave					553	553
Më 31 Dhjetor 2019	104	232	191	525	553	1,605
Zhvlerësimi i Akumuluar						
Më 1 Janar 2018	(31)	(176)	(173)	(267)	-	(647)
Zhvlerësimi për vitin	(10)	(17)	(8)	(48)	-	(83)
Më 31 Dhjetor 2018	(41)	(193)	(181)	(315)	-	(730)
Zhvlerësimi për vitin	(10)	(16)	(7)	(54)	-	(88)
Kapitalizimi i qiarve	-	-	-	-	(184)	(184)
Më 31 Dhjetor 2019	(51)	(210)	(189)	(369)	(184)	(1,001)
Vlera kontabël neto:						
Më 31 Dhjetor 2018	63	36	10	109	-	218
Më 31 Dhjetor 2019	53	23	3	156	369	604

Që nga 31 dhjetori 2019, dhe 2018, Kompania nuk ka pajisje të lëna peng si kolateral. Të gjitha pasuritë janë përdorur për aktivitetet operative të Kompanisë.

Detyrimet e qirase dhe shpenzimet e interes lidhur me qiranë janë paraqitur në notën 18.

13 PASURITË E PAPERKSHME

	Softuer EUR'000
Kosto	
Më 1 Janar 2018	56
Blerjet	-
Më 31 Dhjetor 2018	56
Blerjet	-
Më 31 Dhjetor 2019	56
Amortizimi i Akumuluar	
Më 1 Janar 2018	(50)
Amortizimi për vitin	-
Më 31 Dhjetor 2018	(50)
Ngrakesa për vitin	-
Më 31 Dhjetor 2019	(50)
Vlera kontabël neto	
Më 31 Dhjetor 2018	6
Më 31 Dhjetor 2019	6

14 DETYRIMET BRUTO TË DËMEVE

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Dëmet e Raportuara por jo të Paguara (RBNS)	3,410	3,854
Dëmet e Ndodhura që nuk janë Raportuar (IBNR)	2,069	1,268
Shpenzimet e trajtimit të kërkesave/dëmeve	169	118
GJITHSEJ DETYRIME MË 31 DHJETOR	5,648	5,240
Më 1 Janar		
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	5,240	4,447
Risigurimi i arkëtueshme		
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	5,240	4,447
Humbjet dhe shpenzimet e lindura për rregullimin e humbjeve	4,438	4,250
Humbjet dhe shpenzimet e paguara për rregullimin e humbjeve	(4,031)	(3,457)
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve më 31 dhjetor	5,648	5,240
Risigurimi i arkëtueshme		
DETYRIMET BRUTO TË DËMEVE	5,648	5,240

15 PROVIZIONI PËR PRIMET E PAFITUARA

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
TPL	2,986	2,454
Sigurimi i automjeteve KASKO	159	140
Sigurimet shëndetësore gjatë udhëtimit	749	664
Sigurimet e Garancive	1,020	634
Sigurimi ndaj aksidenteve personale	16	10
Sigurimi kundër zjarrit dhe dëmtimeve të tjera në pronë	54	64
Produktet tjera	213	171
GJITHSEJ PRIMET I PAFITUAR	5,197	4,137

16 DETYRIMET NGA SIGURIMI

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Tatimi i pagueshem	11	94
Të pagueshmet nga risigurimi	245	194
GJITHSEJ DETYRIMET NGA SIGURIMI	256	288

17 DETYRIMET TJERA

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	35	90
Tatimet e tjera të pagueshme	22	10
TVSH e pagueshme	166	24
Qiraja	120	89
Kontributet sociale dhe shendetesore	16	11
Dividenda e pagueshme	-	80
Të pagueshmet tjera	374	294
GJITHSEJ DETYRIMET TJERA	733	598

18 DETYRIMET E QIRASË

	31 Dhjetor 2019 EUR'000	31 Dhjetor 2018 EUR'000
Pagesa Brenda një viti	184	-
Pagesa pas një viti	193	-
GJITHSEJ DETYRIMET E QIRASË	378	-

Kompania ka marrëveshje me qira për pesëmbëdhjet zyre të cilat llogariten në përputhje me SNRF 16. Kontratat e qirasë kanë pagesa fikse dhe kanë maturitet prej një deri në tri vite. Çdo qira pasqyrohet në bilanc si aktiv me te drejtë përdorimi dhe një detyrim i qirasë. Niveli i interesit i aplikuar për detyrimet e qiradhënies është 5%.

Shpenzimet e interesit të njohura lidhur me detyrimet e qirse për vitin 2019 janë në shumë prej 23 mijë euro.

19 KAPITALI AKSIONAR

Kompania është e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Regjistrimit të Biznesit sipas Regjistrimit të Biznesit. Nr. 810791823 më datën 21 Maj 2008 si Shoqëri Aksionare.

Kapitali aksionar përbëhet nga 4,333 aksione me vlerë nominale 1,000 euro dhe janë në pronësi të z. Agim Elshani.

20 PRIMET E SHKRUARA BRUTO

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Auto përgjegjësia	5,750	5,075
Sigurimi kufitar	902	787
Sigurimi shendetesor dhe i shendetit ne udhetim	1,607	1,436
Sigurimi Motor Casco	334	316
Produktet e tjera	1,793	892
Minus: Kthimet e premive	(312)	(604)
GJITHSEJ PRIMET E SHKRUARA BRUTO	10,074	7,902

21 TË ARDHURAT TJERA

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Të hyrat nga Administrata Tatimore	81	354
Të hyrat nga regreset	486	713
GJITHSEJ TË HYRAT TJERA	567	1,067

22 SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TEK BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT

Byroja Kosovare e Sigurimeve ("BKS") administron sistemin për shitjen e sigurimeve të detyrueshëm të automjeteve me përgjegjësi ndaj palëve të treta ("CTPL") në kufirin e Territorit të Kosovës për shoferët e automjeteve me targa të huaja që nuk posedojnë një sigurim të tillë, në emër të të gjitha kompanive të sigurimeve të licencuara në republikën e Kosovës. BKS i shpërndan secilës kompani të sigurimeve në baza mujore një pjesë të primeve bruto të marra dhe pjesën e tyre të kërkesës dhe shpenzimeve administrative. Përveç kësaj, kërkohet secila kompani e sigurimeve që të kontribuojë në BKS për Fondin e Garancisë të Kosovës ("FGK"). Roli i FGK-së është që të paguajë kërkesat/dëmet e sigurimeve që lidhen me aksidentet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara, automjetet e panjohura ose ngjarje të tjera të specifikuara. Shpenzimet për humbjet dhe rregullimet e humbjeve të lidhura me Fondin e Kompensimit dhe sigurimin kufitar përfshihen në humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve.

23 SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Komisionet e shitjes	1,434	1,048
Shpenzimet e punonjesve	854	859
Shpenzimet e marketingut	374	396
Shpenzimet e qirasë	143	325
Shpenzimet e derivative	178	197
Provizionimi i premive të arkëtueshme dhe aseteve tjera	170	150
Shpenzimet e mirëmbajtjes	120	132
Shpenzimet ndaj BQK	139	95
Shpenzimet e zyres	51	63
Shpenzimet profesionale	44	46
Shpenzimet e Internetit dhe telefonit	50	44
Shpenzimet e IT-së	24	23
Shpenzimet e reprezentimit	4	3
Shërbimet komunale	3	3
Shpenzimet e udhëtimit	1	-
Shpenzimet tjera	292	181
GJITHSEJ SHPENZIMET ADMINISTRATIVE	3,881	3,565

24 TATIMI MBI PRIME

	2019 EUR'000	2018 EUR'000
Tatimi mbi primet	297	395
Tatimi mbi te ardhurat	-	-
GJITHSEJ TATIMI MBI PRIMET DHE TË ARDHURAT	297	395

Tatimi mbi Primet: Tatimet mbi primet janë paguar në përputhje me Ligjin Nr. 05 / L-029 "Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave", e cila ishte e efektshme nga 1 Shtator 2015 deri me 5 Gusht 2019. Në përputhje me ligjin nga kompanitë e sigurimeve është kërkuar të paguajnë një taksë primi prej 5% në primet e tyre bruto tremujore. Primet e kthyera dhe rregullimet retrospektive të primeve zbriten nga primet bruto për të arritur në bazën e tatimit. Bazuar në këtë ligj, kompanitë e sigurimeve nuk ishin përgjegjëse ndaj tatimit mbi fitimin në Kosovë për vitet, deri më 31 dhjetor 2018 dhe periudhën nga 1 janari 2019 deri në 5 gusht 2019.

Tatimi mbi te ardhurat: Kompanitë e Sigurimeve i nënshtrohen tatimit mbi fitimin me Ligjin e ri Nr. 06 / L-105 "Për tatimin mbi fitimin e korporatave" i cili është i efektivë nga 5 gusht 2019. Në përputhje me Ligjin, kompanitë e sigurimeve u kërkohet të paguajnë tatimin në të ardhurave të korporatave në masën 10% në fitimet e tyre të tatueshme. Sipas interpretimit të Autoritetit Tatimor posaçërisht për industrinë e sigurimeve, duke filluar nga 5 gusht 2019 kompanitë e sigurimeve për qëllime tatimore duhet të llogaritin veçmas primet e shkruara bruto, rezervat e primit të pafaluar, rezervat për dëme vetëm për periudhën 5 gusht 2019 deri në 31 dhjetor 2019. Në tabelën e mëposhtme dakordimi i humbjeve sipas kontabilitetit dhe legjislacionit tatimor është paraqitur :

	2019 EUR'000
Humbja për periudhën 5 gusht deri më 31 dhjetor 2019	(194)
Shkalla e tatimit në 10%	(19)
Efekt i tatimor i shumave që nuk janë të zbritshme (të tatueshme) në llogaritjen e të ardhurave të tatueshme	
Ndryshimet në rezervat teknike	-
Shpenzimet e tjera të pazbritshme	-
Humbjet tatimore të papërdorura për të cilat asnjë pasuri e tatimit të shtyrë nuk është njohur	19

25 ZOTIMET DHE KONTIGJENTËT

Çështjet gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania është e përfshirë në kërkesa të ndryshme dhe veprime juridike. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe këshillave të brendshme dhe të jashtme profesionale, menaxhmenti është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë dispozitat që janë bërë në këto pasqyra financiare.

Më 31 dhjetor 2019 ka 475 raste gjyqësore me rezerva në shumë prej 1,279 mijë euro (2018: 467 raste ligjore, me rezerva në shumën 1,471 mijë euro).

Menaxhmenti i Kompanisë rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me procedurat ligjore, së bashku me procedurat dhe llogaritë e arkëtueshme të mundshme ndaj Kompanisë, të cilat mund të lindin në të ardhmen. Megjithatë rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të konstatohet gjithmonë me saktësi, menaxhmenti i kompanisë beson se nuk ka mundësi të lindin detyrime materiale mbi dispozitat e rezervuara.

Detyrimet tatimore

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2011 deri 2016 ishin inspektuar nga autoritetet tatimore. Si rezultat i inspektimeve tatimore Kompania ka paguar tatime shtese, inters dhe gjoba në vlerë 447 mijë euro të cilat njihen si shpenzime gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2017. Pas raportit të inspektimit tatimor, kompania ka ngritur padi kundër administratës tatimore për tatimin shtesë të paguar, interesat dhe gjobat, dhe në dhjetor 2018 ka marrë vendim të favorshëm nga Gjykata Themelore e Prishtinës, të cilët kanë miratuar pjesërisht kërkesën e Kompanisë. Pas vendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, kompania ka njohur të arkëtueshmet nga administrata tatimore në shumë prej 354 mijë euro, të përbëra nga tatimi shtesë i paguar në vitin 2017 pa dënime dhe interesa. Gjatë vitit 2019. Gjykata e Apelit ka vendos ne favor të Kompanis dhe gjate vitit shume prej 225 mijë euro janë kompenzuar me detyrimet tatimore të Kompanisë. Po ashtu gjatë vitit 2019 janë njohur të hyra në shumë prej 81 mijë euro lidhur me rregullimet tatimore

26 TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHURA

Një palë lidhet me një subjekt ekonomik nëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet nga ose është nën kontroll të përbashkët me subjektin ekonomik, pala ka interes në subjektin ekonomik që i jep ndikim të rëndësishëm mbi subjektin, pala ka kontroll të përbashkët mbi subjektin ekonomik, pala është një bashkëpunëtor ose pala është anëtar i personelit kyç menaxhues i subjektit ekonomik ose kompanisë mëmë.

Kompania ka transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të aktiviteteve të biznesit. Tabela e mëposhtme paraqet volumnin dhe bilancet nga transaksionet e palëve të lidhura që nga dhe për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

	2019	2018
	EUR'000	EUR'000
Shpërblimet për menaxhmentin	100	100
Të arkëtueshmet dhe asetet tjera	509	1,264
GJITHSEJ	609	1,364

27 NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Përhapja e COVID-19 në Republikën e Kosovës ka shkaktuar ndërprerje të biznesit. Kompania pret që kjo çështje të ndikojë negativisht në rezultatet e saj të operimit. Sidoqoftë, ndikimi financiar dhe kohëzgjatja nuk mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme në këtë kohë

Nuk ka ngjarje materiale pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që mund të kërkojnë rregullim apo shpalosje në këto pasqyra financiare.

PASQYRAT PLOTËSUESE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

1 TABELA 1 - MARGJINA E AFTËSISË PAGUESE

Tabela për Llogaritjen e Aftësisë Paguese		2018	2019
		EUR'000	EUR'000
1	Tabela e rezervave për kërkesa/dëme		
1.1	Kërkesat për dëmet e papaguara në fillim të periudhës	4,447	5,240
1.2	Dëmet/kërkesat e paguara	3,457	4,031
1.3	Kërkesat për dëmet e papaguara në fund të periudhës	5,240	5,648
1.4	Humbjet e akumuluar (1.2 + 1.3) - 1.1	4,250	4,440
1.5	Mesatarja e humbjeve të akumuluar	2,921	3,354
2	Tabela e pjesës së kërkesave të ri-sigurimit		
2.1	Pjesa e ri-sigurimeve për kërkesat në pritje në fillim të periudhës	4	-
2.2	Ri-sigurimet e pranuar		
2.3	Pjesa e ri-sigurimeve për kërkesat në pritje në fund të periudhës	(15)	-
2.4	Pjesa e ri-sigurimeve për kërkesat e akumuluar	(19)	-
2.5	Humbjet e akumuluar neto (kërkesat e mbajtura)	4,250	4,440
2.6	Niveli i mbajtjes	100%	100%
2.7	Mesatarja e nivelit të mbajtjes	99.50%	100.00%
3	Bazuar në prime		
3.1	Primet e shkruara bruto	7,902	10,074
3.2	Ndryshimet në prime	38	(1,061)
3.3	Për QI: 11,12,13 rritja e primeve për 50%		-
3.4	Të tjera (tatimi dhe ri-sigurimi)	(395)	(924)
3.5	Gjithsej	7,545	8,090
3.6	Shtresa e parë (e fiksuar në 10 milion)	10,000	10,000
3.7	Shtresa e dytë (më shumë se 10 milion)		
3.8	Përqindja e shtresës së parë (e fiksuar)	18%	18%
3.9	Përqindja e shtresës së dytë (e fiksuar)	16%	16%
3.10	Rezultatet bazuar në prime	1,358	1,457
3.11	Niveli i mbajtjes	100%	100%
3.12	Rezultati i aftësisë pague bazuar në prime	1,358	1,457
4	Bazuar në kërkesa		
4.1	Kërkesat e akumuluar bruto (shiko tabelën e kërkesave/dëmeve)	4,250	4,438
4.2	Shtresa e parë (e fiksuar)	7,000	7,000
4.3	Shtresa e dytë	-	-
4.4	Përqindja e shtresës së parë (e fiksuar)	26%	26%
4.5	Përqindja e shtresës së dytë (e fiksuar)	23%	23%
4.6	Shuma e shtresës së parë	1,105	872
4.7	Proporcioni neto dhe bruto i kërkesave të akumuluar	100%	100%
4.8	Përqindja minimale	50%	50%
5	Rezultati i aftësisë pague bazuar në kërkesa	1,105	872

SHTOJCA PLOTËSUESE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

5	Aftësia e kërkuar paguese	2018	2019
5.1	Bazuar në prime	1,358	1,457
5.2	Bazuar në kërkesa	1,105	872
5.3	Aftësia e kërkuar paguese	1,358	1,457
5.4	Aftësia e kërkuar paguese për vitin paraprak	1,368	1,457
5.5	Aftësia paguese bazuar në rritje prej 150%	2,052	2,185

2 TABELA 2 – LLOGARITJA E KAPITALIT

Tabela për llogaritjen e Kapitalit		2018	2019
		EUR'000	EUR'000
I	KAPITALI THEMELUES	5,509	5,795
1	Kapitali aksionar i paguar i siguruesit në para të gatshme	4,333	4,333
2	Rezervat e kapitalit (rezervat e njohura me ligj dhe rezervat e lira)	-	-
3	Fitimet e akumuluar të transferuara pas zbritjes së dividendëve që duhet paguar	1,176	1,462
II	ELEMENTET ZBRITËSE NGA KAPITALI THEMELUES	-	-
1	Riblerja e aksioneve të veta	-	-
2	Investimet në pasuri (jo-materiale) të paprekshme;	-	-
3	Humbjet e transferuara dhe humbjet e vitit të tanishëm;	-	-
4	Diferenca midis rezervave për zbritje dhe pa zbritje	-	-
III	KAPITALI SHITESË	-	-
1	Kapitali aksionar i siguruesit, i përbërë nga lëshimi i aksioneve preferenciale sipas shumës nominale të tyre të paguar në para të gatshme në kapitalin e siguruesit	-	-
2	Instrumentet e borxhit të varur	-	-
3	Rezervat e kapitalit të lidhura me aksionet preferenciale	-	-
4	Elementet e tjera	-	-
IV	KAPITALI RREGULLATIV, (I - II + III)	5,509	5,795
V	ELEMENTET ZBRITËSE NË LLOGARITJEN E KAPITALIT	-	-
1	Pjesëmarrjet ose posedimet në pronësi të kompanive të tjera	-	-
2	Investimet në instrumentet e borxhit të varur	-	-
VI	PASURITË JO-LIKUIDE	2,256	1,591
1	Llogaritë e arkëtueshme të primeve dhe debitorët nga ri-sigurimi për më shumë se 90 ditë	838	609
2	Huazimet dhe llogaritë e arkëtueshme me palët e lidhura	1,412	509
3	Debitorët dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme, të cilat rrjedhin nga aktiviteti i sigurimit	-	258
4	Huazimet nga ndërmjetësit dhe agjentët	-	211
5	Shpenzimet e paguara 100% paraprakisht dhe pasuritë e shtyra tatimore	-	-
6	Pasuritë e tjera, të pa përjashtuara nga ndonjë përgjegjësi ose detyrim	-	-
7	Pasuritë e tjera të cilat nuk janë lehtësisht të konvertueshme në para të gatshme	-	-
8	Pasuritë e pa prekshme	6	6
9	Të tjera	-	-
VII	PRONA NETO – KAPITALI I DISPONUESHËM (IV - V - VI)	3,253	4,248
VIII	FONDI I GARANCISË SIPAS LIGJIT	3,200	3,200
IX	KËRKESAT PËR KAPITAL SIPAS FONDIT TË GARANCISË	53	1,005
X	KËRKESAT PËR MBULIM TË AFTËSISË PAGUESE	2,052	1,751
XI	KËRKESA FINALE PËR RITJE TË KAPITALIT	-	-

3 TABELA 3 PASURITË / INVESTIMET NË MBULIMIN E PROVIZIONEVE TEKNIKE

Nr.	Pasuritë / Investimet në mbulimin e provizioneve teknike	Vlera aktuale e investuar EUR'000	% e pasurive të lejuara për të mbuluar provizionet teknike	Shuma e lejuar me rregullore EUR'000
1	Depozitat në bankat e licencuara në Kosovë gjatë 3 muajve, (duke përjashtuar kapitalin themelues)	8,675	Të pakufizuara	8,675
2	Letrat qeveritare me vlerë		-	17
3	Toka dhe Ndërtesat	83	20% në gjithsej 5% individualisht	83
4.2	Xhirollogaritë rrjedhëse	367		367
4.1	Paratë e gatshme në dorë	10		10
4	Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	377	3%	377
5	Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimet, neto nga detyrimet	-	Të pakufizuara	-
6.1	Me normë kreditore <BBB	-	-	-
6	Pjesa e ri-siguruesit në provizionet teknike, neto nga detyrimet	767	-	767
7	Interesi i vlerësuar i investimeve	66	5%	66
8	Llogaritë e arkëtueshme nga aktivitetet sigurorese, deri në 90 ditë	659	Deri në 20% të PPF-së	659
9	Pasuritë e tjera fikse, të ndryshme nga pika 3.	604	5%	542
10	Gjithsej investime që mbulojnë provizionet teknike	11,284		11,222

Nr.	Provizionet Teknike	2019 EUR'000
1	Provizionet për primet e pa fituara dhe risku i pasuksesshëm	5,197
2	Kërkesat për dëmet e papaguara në fund të periudhës	5,648
3	Provizionet e tjera teknike	-
4	Shuma totale e nevojshme për të mbuluar provizionet teknike	10,845
5	Pasuritë që mbulojnë provizionet teknike	11,222
6	Gjithsej provizionet teknike	10,845
7	Diferenca (5-6)	377
8	Mbulimi në % (5/6)	103%
9	Mbulimi i nevojshëm sipas rregullores (6*100%)	10,845
10	Teprica e pasurive (5-9)	377